

NË BEË  
TË TATUAZHIT TËND

*Nga i njëjti autor:*

Marrja e gjakut (*Onufri, 2018*)

Pragu i braktisjes (*Albas, 2019*)

Andreas Dushi

NË BESË  
TË TATUAZHIT TËND

*Roman*

Onufri

*Redaktore:*  
Luljeta Dushi

© Onufri, 2022

*Të gjitha të drejtat e botimit, në gjuhën shqipe,  
brenda dhe jashtë kufijve të Shqipërisë,  
i takojnë Shtëpisë Botuese Onufri*

ISBN 978-9928-354-96-9

PRINTED AND BOUND IN ALBANIA BY ONUFRI

Rr. "Konferenca e Pezës", Nr. 71, Kodi Postar 1027, Tiranë;  
Tel & Fax 00355 42 220 017 / 270 399  
[www.onufri.com](http://www.onufri.com); E-mail: [info@onufri.com](mailto:info@onufri.com)

*Ka vetëm një problem filozofik  
me të vërtetë serioz: vetëvrasja.*

Albert Camus



## *Gojëdhëna që po priste dikë për ta treguar*

Lulet e kumbullës po rrëshqisnin nëpër degët e holla, pa çelur plotësisht. Kjo ishte shenja që iu desh për ta kuptuar se pranvera po vinte. Prandaj Çamuku, pa humbur kohë, mbështolli pak bukë në një trastë të gjelbër, e lidhi *fjok* në fundin e një kërrabe të gjatë pak më shumë se katër pëllëmbë – aq kishte qenë atëherë kur i ati për herë të parë ia kishte ngarkuar atë punë, por me kohën, duart i ishin tharë e zvogëluar – e vuri mbi supin e djathtë dhe u nis, pa i bërë zë njeriu. Kishte ardhur koha për t’u ulur në gurin e këndit të skajit të djathtë të kullës e për të pritur sa t’i shfaqej lëkura e zhvoshkur. Paçka se s’do të rrinte shumë, u përgatit për katër a pesë ditë të plota. Por me të arritur, pa se lëkura e zhvoshkur, kruspulluar si pite, thahej nën diellin që ngrihej gjithnjë e më lart.

“Pse me vonesë këtë herë?” u dëgjua zëri i ethshëm dhe i etur.

“Mendova se isha në kohë, më vjen keq...”

“Dje këtu para të ka kaluar djali dhe nuk e ngacmova, pasi jote shoqe asnjëherë nuk e ka mallkuar. Po ta kishte

bërë, shtuar edhe ardhjen tënde vonë, sot djalin do ta kishe... S'po e them, meqë asgjë nuk ndodhi. Asgjë.”

Nga zbrazëtia e vogël mes murit e themeleve, nxori kokën me gjuhën e dalë, këputur në mes nga kushedi ç'darë – e kishte pyetur Çamuku të atin për këtë, por ai i kishte thënë t'i linte marrinat – gjarpri i shtëpisë. Vit për vit, prej kur nuk mbahej mend e nuk mund të rrëfehej, familja e Çamukut lidhte besën me të në fillim të pranverës.

*Nuk të luej, mos më luej  
Për askënd nuk jem të huej,  
Kur rishtaz dimni të fillojë  
Bashkë me ty njeri t'jetojë  
Bashkë me mue gjarpni t'rrnojë*

Gjarpri u zvarrit edhe më tepër, nxori gjysmën e trupit e tek tundej si ta kishte shkelur dikush, e paralajmëroi se kjo nuk ishte shenjë e mirë. Mandej u zhduk në strofkullën e vet.

Çamuku s'i tregoi askujt ç'i kishte ngjarë, por u kthye brenda në kullë akoma pa u zgjuar njeri. Gratë, njëra mbushte ujë, tjetra pastronte për herë të fundit oxhakun e ndonjëra, patjetër do të kishte dalë me bagëtinë a për t'u ngarkuar me barrën e druve. Pra dita po fillonte ta plotësonte mozaikun e vetvetes njëlloj si gjithë të tjerat para e pas saj.

“Babë, babë, shih çfarë gjeta.”

Ai po tymoste i mbështetur në pragun e oxhakut të



shuar, ulur në një postiq të zi, rrjepur nga *cjapi i dimnit*, sikurse quhej ai që therej sapo fillonte i ftohti për t'ia tharë mishin e me të ta shtynin një pjesë nga stina prej ngrice. Kur pa se djali mbante në dorë lëkurën e zhvoshkur të gjarprit, u ngrit, la çibukun e ndezur mbi postiqen që u dogj dhe ia flakëroi djalit me shuplakë. Jo pse ai i vogli kishte faj, por sepse vetë Çamukut iu kujtua që nuk e kishte marrë lëkurën për ta varrosur në Çinarin e Madh, sikurse tradita kërkonte.

Ia hoqi nga duart pa kujdes dhe cipa e hollë iu shpërbë si hiri i duhanit. Pa rreth e rrotull, sikur po sigurohej se askush nuk po e përgjonte dhe grushtin me atë gjë pa trajtë e formë e hodhi në kamin. “Shpejt, barrën e druve!” urdhëroi me sa zë mundi, por vonuan t’i bindeshin. Të gjithë drutë, gruaja e barrës së asaj dite i kishte sistemuar në jerevi. Kur pyeti cila grua ka qenë sot për dru, i thanë se e tija. E thirri pranë, e shtrëngoi pas qafe, nxorri thikën nga milli i vogël sa një xhep varur në brez dhe i preu bishtalecin që i ra në tokë e iu spërdordh si gjarpër – me ta menduar këtë shtrëngoi sytë fort me mishin e bërë kokërr. “Të zgjidh nga kunora e martesës. Shko në gjininë tënde,” i tha dhe i ktheu kurrizin. Me kokën poshtë, ajo doli për të marrë rrugën drejt vdekjes së sigurt nga i vëllai, i ati apo dikush tjetër i familjes së dikurshme.

Sa vonoi të ndizej zjarri e të fillonte djegia, nga rrudhat e ballit po i rrëshqisnin djersë të ftohta. Tani jam armik jo vetëm me gjarpurin, por edhe me shpirtrat e të vdekurve vite e vite më parë, mendoj. Nuk e vuri re nëse cirkat e

djersës i ranë në sy, apo ishin lot ato çka i rrodhën poshtë qepallave.

E dinte se kjo besëlidhje e paplotë do ta cyste gjarprin të hakmerrej në ndonjë mënyrë mizore, pa u përfshirë vetë, drejtpërdrejtë, dhe kjo s'i shqitej dot nga mendja. Por kur filluan problemet e zakonshme të verës, e gjitha u venit me ngadalë. Njëri prej tyre, sivjet më i rëndë se vitet e tjera, ishte ai i ujit për delet. Lugu përreth Synit të Vogël, sikurse asnjëherë më para, qe tharë i tëri dhe përrrenjve të zakonshëm u kishin mbetur vetëm vijat zgavruese që porsi gjarpër – me ta menduar këtë krahasim fryma iu ndal: iu kujtua se i tillë kishte qenë edhe krahasimi me bishtalecin e prerë të së shoqes, dy herë gjarpri, ai që s'duhej përmendur, *kjoftëlargu*, po mirë, me gruan e dikurshme ç'bëhet, sikur deshi ta largonte mendjen deri sa iu kujtua se vëllai i saj ia kishte sjellë trupin e pajetë të motrës së tij, me lutje të përunjur për ta varrosur ai që lëshimi i saj, ndarja, të mos merrej vesh – kishin ngrënë tokën. Te *Lugu i Gjarpnit* ishte e kotë, gjarpërinjtë e dalë nga letargjia do t'ua pickonin këmbët e holla dhenve të vegjël. Pastaj, jo, s'do t'ia besonte një vendi me *gjarpër* gjithë tufën e vet. Duhej që qengjat dhe kecat, bashkë me delet e dhinë të çoheshin diku tjetër, tutje, andej nga Pylli i Territ ku ujquit e uritur që thuajse plasnin nga vapa aty kishin për të qenë, në pritë si përherë, por rrugë tjetër s'kishte. Ose t'i humbte të gjitha nga etja, ose një pjesë nga ujquit. T'i shoqëronte ato ditë për ditë, kjo qe e para detyrë e familjes që iu ngarkua djalit të vogël. Sa u gëzua

i shkreti, pa e ditur se qysh mëngjesin e parë, ujqit do ta shqyenin për të kruar dhëmbët me eshtrat e tij pasi kishin shfarosur më shumë se gjysmën e tufës.

“Ani moj gra, mos e kjani! Ky ka kenë djali i ujqut!”, tha e ëma e Çamukut, gjyshja e djaloshit kur sollën në shtëpi copat e çikat e mbetura nga trupi. Dhe kishte njëfarë të drejte. Në ato zona, gjithnjë djali i fundit lindej *për ujk*: edhe po të vritej nga ky i fundit, s’i bënte dëm familjes pasi mashkullija ishte mjaft e gjallë e ruhej edhe ndër djem të tjerë.

“Epja o Zot pushimin e pasosun...” thirri prifti kur arka me trupin e djalit po futej në dhë pranë së ëmës. “Pse jo në të njëjtin varr?” u diskutua atë mëngjes. “Jo! Burrat varrosen tre pash më thellë se gratë.”

“E e shndritë drita e pambarueme!” u përgjigjën njëzëri gratë. Burrat, në heshtje, hidhnin me lopatë grumbuj dheu me vrunduj arome lulesh të njoma për të mbushur gropën. Në krye u ngul thellë guri i varrit, një kryq ku nuk shkruhej asgjë, me në majë një dele të gdhendur, poshtë një peshk, në të majtë një kërrabë me kokë të kthyer fort e në të djathtë, siluetën e një njeriu.

Gjatë drekës së përmortshme dëgjohej vetëm përplasja e bukës me kazanat plot mish jahni në qendër të sofrave, deri sa heshtjen e thurur nga tegelat e këtij tingulli tërësisht unik e theu vajtojca, rikthyer me vrap tek i zoti i shtëpisë pasi ky e kishte paguar një herë.

“Oh, çka me ju thanë... Po na nuk kena vendosë gjarpnin te vorri i djalit mor të mjerët na, oi, oi, oi...!”

“Zhduku, ik, kris!” u ngrit në këmbë e bërtiti Çamuku me të dëgjuar sërish fjalën gjarpër. Ishte vonë, ama. Ai ndjeu t’i shtrëngohej përmbi çakçirë, nga këmba drejt gjurit, pastaj në kofshë, iu ngjit në bel, i rrëshqiti nëpër gjoks e iu mblodh rrotull qafës, gjarpri i shtëpisë, koka e të cilit spërdridhej si fije e thatë bari.

“Me ty e me bijtë e tu deri tek ata që do të të mbajnë mend, besën e kam të pathyeshme! Por do të vijë një ditë kur kjo çfarë më ke bërë, duke mos më kujtuar në varrimin e tënd biri, do t’u kthehet atyre që as nuk kanë me e ditë lidhjen me ty, në një mënyrë që mendja s’ta pret! Unë tani iki dhe gjej strehim diku tjetër, por ti mos harro se kjo shtëpi mbetet pa gjarpër. Do ju vijë bolla, do të bëheni shtëpi me bollë! Përzutë gjarpërin e zanave për bollën e orëve! Copa-copa, porsi mishi i kujt do ta harrojë se është bir’ i yti, kanë me ra gurët e kësaj kulle! Mes orëve e zanave, përherë do të fitojnë zanat!”

**KRERËT  
E PARË**



## Kreu I

Qe mëngjes i zbërdhulët prej një shtrese të trashë bryme, aq sa nuk ndahej pjesa që i takonte qiellit nga ajo që i takonte tokës, ai i atij shtatori pa asnjë ditë me diell kur me të çelur sytë, i thashë vetes se po të mos shkoja në një qendër tregtare deri pasdite, do të çmendesha. Të gjithë në shtëpi ishin në gjumë. Nuk e pashë orën nga frika mos dikush zgjohej e për rrjedhojë, gjithçka po planifikoja do të vonohej.

Hyra në banjë ku mbarova punë shpejt, pasi lava edhe sytë me dy gishtat e njomur pak nga uji i rrjedhshëm dhe u ktheva në dhomën time. S'ishte *dhoma e gjumit* sepse aty *gjumi* mbushte pjesën më të vogël të kohës që kaloja.

Brenda thesit të improvizuar me këllëf nënkrese, pasi herë pas here e përdorja si të tillë, mora aq rroba sa shtrëngohen brenda grushtit. Dolën porsi komplet i gjithë gjërave të nevojshme për të veshur: një bluzë, një palë pantallona, një palë çorape ndryshe njëri prej tjetrit dhe një xhup i rreckosur, me shumë mundësi nga mola. Prej vitesh

dergjeshin aty, në pritje t'ia çonim jetimores por asnjëherë, sikurse im atë thoshte kur binte fjala, *s'u bëmë mbarë*. Kyçet e fryra të këmbëve e duarve, mbetur jashtë, paçka se s'qe aq ftohtë sa të mërdhisja, po më bezdisnin. Ndaj mora një tjetër xhup nga prifti në të dalë dhe e hodha krahëve. Në vend të tij lashë rreckën e nxjerrë prej thesit.

*Hera e parë kur e kam dëgjuar fjalën prifti qe një mëngjes para se të nisesha për në shkollë. Nuk e kujtoj për çfarë, por im atë më tha ta merrja te prifti. Çfarë kujtoj, shumë qartë madje, është e qara ime e padurueshme në kishë kur burri i cili do të më hidhte tri pika uji mbi kokë ditën e pagëzimit, u prezantua si "prifti". Nëse varësja e rrobave ishte bërë njeri, i kishte marrë për vete rrobat tona?*

Për çudinë time, makina u ndez menjëherë. Çak-mak do të thoshte im atë. Më ka munduar gjithmonë fakti pse disa fjalë, shpjegimin e kanë brenda vetes, nuk janë arbitrare. Çfarë ua jep atyre këtë të drejtë? Çak-mak është njëra syresh pasi, kur lëviz gishtin në mrroklën e tij, zhurma që lëshon i përgjigjet këtij tingulli që përdoret si emër. Ose jo, nuk ndodhte vërtetë kështu. Mundet edhe që, qysh në krye të herës, të parët tanë, ata të cilët eshtrat tanimë i kanë të thërrmuara nën kushedi cilin pallat, e kanë bindur veten se ajo zhurmë është e atillë, prandaj dhe ne ashtu e dëgjojmë.

Jo, çfarë them?! Nuk ia kam idenë kur është krijuar çak-maku i parë, por me siguri jo aq herët sa duket nga ç'shkrova më lart. Më mirë të heq dorë, edhe gjoksi po më dhemb nga boshi i përgjithshëm që e mbush çdo mëngjes, ndaj le të



ndez një cigare. Kam këtë rrugicën e gjatë e kaq të ngushtë përpara, si gjuhë nëpër të cilën makina duhet të kalojë për të rënë mandej brenda barkut të qytetit. Krahasim koti, por nga t'ia mbaj: është një ves i poshtër dhe i pashmangshëm për mua, duhet të krahasoj gjithçka me diçka. Po të mos e bëj, ndihem i dhunuar nga mungesa e guximit për ta bërë, nuk ngopem me ajër, djersë të ftohta më rrëshqasin nga balli drejt vetullave dhe mandej më krisen mbi hundë. Edhe tani e njëjta gjë po ndodh, veçse jo për këtë shkak. Nuk po e kuptoj pse e kam marrë me kaq shumë ankth daljen nga rrugica. Po e përjetoj si diçka të pamundur dhe po i them vetes gjithë justifikimet e botës pse nuk ia dola, ndonëse thuajse mbaroi. Tani jam gati, po, mund ta ndez cigaren.

Gropëza e cekët buzë levës së marshit ka brenda më shumë se dhjetë çak-makë nga ata të vegjlit, prodhuar prej BIC. Të gjithë në ngjyra të ndryshme. Sa herë blej një paketë, marr edhe një të tillë. Shumë më kanë humbur. M'i kanë vjedhur. Çak-mak. Dreqin, sërish e njëjta fjalë! Nuk ka mundësi të jetë rastësi, po ndodh për një arsye! Diçka duhet të dëgjoj, një mesazh, një lajm, kumt, njoftim, nuk e di. Nëpërmjet kësaj, patjetër është universi që më flet, por çfarë po më thotë? Çak – mak, çak – mak, çak – mak... Po! Çak – maku shërben për të ndezur zjarr dhe... ka mundësi... jo, me siguri! Po! Do të ndodhë diçka dhe makina do të më kapet flakë!

Është akoma herët, në rrugicë nuk ka trafik dhe, me indietro arrij deri poshtë shtëpisë. Kam frikë të vijoj më tej. E si të mos kem, gjithçka është kaq e qartë!



Ka shumë kohë që dua të vdes. Disa herë kam provuar ta vras veten, por në mënyra më pak të dhimbshme. Nëse e gjitha ka për të marrë fund, nuk gjej arsye që kjo të ndodhë duke u përcëlluar brenda një grumbulli hekurishtesh. Atë ditë janari, në fillim të vitit, mund ta shkrepja armën me tytën e mbështetur në ballin tim dhe kaq. Por s'ë bëra, më mungoi guximi, sikurse gjithnjë më ndodh. E hodha në lumë, me forcë, nga bregu i tij plot hekura të ndryshkur dhe u ula e qava me thëllim. Mund edhe të mbytesha, sërish një vdekje më pak e vështirë së djegia. As këtë nuk e bëra. Nuk ka kuptim tani të vdes në të atillë mënyrë. Jo, kthehem dhe kjo merr fund.

Prit, çfarë po them?! Po vazhdova, gjithçka do të marrë fund! Do të vdes, me justifikimin e qartë se nuk po vras veten. Të gjithë do të jenë të lumtur dhe për mua as s'do të ketë brejtje ndërgegjeje, as s'do të më duhet guxim. Ja, po më vjen në pjatë mundësia e artë! Pse ta refuzoj?

Më duhet arsye? Ja, e them unë: Jam i ri! Kam gjithë jetën përpara! Po vdiqa tani, ajo parcelë e kohës që më është taksur qysh në zanafillë do të shkojë dëm, nuk do të përdoret. Mjafton kjo për të mos e vrarë veten!

Ah, po, jam i ri. Pra kam dhe kaq shumë vite për të vuajtur nga ankthi, stresi, depresioni; për të menduar ditë për ditë vetëvrasjen, për të prerë dorën me thikë që të ndiej diçka, për të djegur pëllëmbën me çak-mak që të përjetoj diçka.

Prapë kjo mut fjale, tingull i mallkuar. Do të vazhdoj sepse asgjë nuk do të më gjejë, për fat të keq. Asgjë! Njëllon

si rrugën, edhe jetën. Edhe ankthin, depresionin, nevojën për të ndier, përjetuar, jetuar. E pse? Ç'vlerë ka e gjitha kjo? Ç'kuptim ka? Asnjë! As edhe një të vetëm!

I gjithë ky vrull më iku shpejt, sapo u kujtova se më pihej cigare. Sërish kërkova çak-makun dhe çdo gjë u ktheu nga e para. Por e kam ndarë mendjen të vazhdoj. Sepse e di se po nuk e bëra dhe vendosa të kthehem në shtëpi, do të çmendem.

Ej, e gjitha zgjidhet shumë thjesht. Ndalo, kontrollo, vazhdo! Njerëzit në këtë mënyrë kanë bërë revolucione!

Ëndrra ime qysh kur fillova të ëndërroj, dhe kjo ka ndodhur vërtetë në një moshë shumë të vogël, ka qenë dhe mbetet të frymëzoj një revolucion. Të thjeshtë, por aspak paqësor. Një përmbysje të sistemit për ta zëvendësuar me një tjetër, ndërmjet të cilëve ndërtohet, me themele të dobëta, një anarki e atillë që të rrëzohet pikërisht nga sistemi i ri. Për të bërë diçka të tillë nevojiten shumë gjëra, më kryesorja ndër të cilat është guximi. Sikurse kushedi sa herë mendoj se e kam shkruar, unë nuk kam guxim!

Njeriu, frikërat e tij më të mëdha i thotë përherë me zë të lartë, herë drejtpërdrejtë e herë tërthorazi, pasi kështu ia del të ndihet i sigurt se përballë tyre nuk është vetëm.

U ndala si përfundim, duke e ngjeshur gomën sa më fort të ishte e mundur me betonin anësor të trotuarit, aq sa ajo u shkri pak, sikurse vura re nga era e rëndë. Gërrvima e fortë porsi lehje e stërgjatë më bëri ta shtyp pedalin e frenës me presionin e një të marri. Tërhoqa levën që çel kofanon,

dola nga makina dhe shkova të shoh nivelin e ujit. Vura re se kisha bërë gjithë atë rrugë; uji gurgullonte pa pushim, ndaj m'u desh të prisja goxha sa të qetësohej. Shkoi diku gjysmë ore, e kaluar me mendimin se si të mos mendoj, çka në vetvete është mendim torturues. Gjithsesi, për fat të mirë, minutat kaluan dhe tani mund ta kontrolloj. Uji është mbi nivelin që shënohet me MAX. Makina nuk do të kapet flakë. Ose të paktën, jo për këtë shkak.

Ndezja e dytë e makinës ishte më e vështirë. Me të kthyer çelësin në kuadër, u lëshua një ulërimë e kithët, si gjysëmklithmë e një lejleku të saposhpuar tejpertej nga plumbi. Ngrita levën e sinjaleve në të majtë, çka do të paralajmëronte shoferët pas meje se po dilja, eca pak e u gjenda në rrugë. Mandej e drejtova timonin dhe vazhdova drejt.

Muzika e përzgjedhur nga unë për të më shoqëruar, fillimisht më këndelli, por pastaj, skematizmi i saj, kaq tipik në çdo gjë unë bëj, them apo mendoj, nisi të më shqetësojë. Prandaj vendosa ta kaloj në radio ku do të dëgjoja cilëndo frekuencë të më kapte më së pari, proces gjatë të cilit frika mos tek e hiqja vëmendjen nga rruga do të bëja ndonjë aksident, nuk m'u nda. Fatmirësisht, asgjë nuk ndodhi. Menjëherë, një luzmë fjalësh të ndyra rrëshqitën si vaj i ndenjtur që varej në vija të gjymtuara pentagrami. Nuk po më pëlqente aspak, por buzëqesha i lumtur se më në fund po dëgjoja atë çka *gjithë të rinjtë* dëgjojnë. Jam në një fazë kur duhet të gjej një mënyrë për t'u bërë pjesë e tyre.

*Prej vitesh e pata kuptuar se ajo çka unë konceptoja si rini nuk pritej gjëkund me atë çka të rinjtë quanin të tillë. Ndodhi kështu: më ftuan në një party, diku aty nga ora njëmbëdhjetë e darkës. Që të përshtatesha, u veshja krejt ndryshe nga zakonisht, me xhinsa të grisura që i bleva vetëm për atë rast e tani dergjen në atë thes-thithës, dhe me një triko jeshile në të verdhë. Kur hyra, kuptova se dëshira për t'u përshtatur më kishte kthyer në një njeri pa identitet, pasi u ngjaja të gjithëve në gjithçka e për rrjedhojë, askush s'e vuri re praninë time.*

*Zallamahia e tmerrshme që quhet kërcim filloi. Rrija në këmbë, me një gotë plastike brenda së cilës dikur kishte pasur birra. Të gjithë më kalonin pranë sikur të mos e vinin re praninë time. I vetëm shtyva edhe disa minuta, deri kur kokulur dola nga ajo pjesë e nëntokës ku ishte bari dhe vajta në shtëpi. Para se të më zinte gjumi, tymosa shumë cigare. Atë natë e fillova cigaren. Atë natë mendova se u rrita.*

*Më pas, në dëshpërimin thellësisht të errët që sjell vetmia, i kam thënë vetes se edhe për mua fillimi i cigares lidhet me një party. Por kjo asnjëherë nuk e zbuti ngurtësinë e të ndjerit i papranuar.*



## Kreu II

Si u mbyll kapaku i varrit, bashkë me shokët e vet iku në mejhanen përballë ndërkohë që familjarët e së ndjerës po prisnin ngushëllimet. Mbaruan më shpejt nga sa mendonin, prandaj ai dhe shokët u rikthyen. Kur po pinin, u tha edhe atyre se me siguri, ngulur në nofullën e sipërme, i kishte parë katër dhëmbë ari. Tani kur ishin të vetmit të gjallë, sikurse shpeshherë bënin, e çelën sërish varrin, ngritën kapakun e arkivolit dhe i hapën gojën së ndjerës. “A ju thashë?” bërtiti ai i entuziazmuar kur pa se nuk ishin katër, por gjashtë dhëmbë të tillë.

Pasi ia shkulën ndërkohë që ai i mbante gojën hapur dhe tre shokët e tjerë ia tërhiqnin me dara një e nga një, mbyllën sërish kapakun e arkivolit, pastaj atë të varrit dhe bënë disa hapa pas. Në heshtje, ishte e qartë se atij i takonin tre dhëmbë ndërsa tre të tjerëve nga një. Askush nuk bëri fjalë apo kundërshtoi.

Kur po iknin për t’u ndërruar në dhomën e vogël, panë një burrë në të dyzetat.

“Çfarë i bëtë varrit të sime mëje?” i pyeti me zë të dhunshëm. Nga pas tij dolën edhe një duzinë burrash e djemsh.

Të frikësuar, kapërdinë pështymën me zhurmë. Nuk u përgjigjën.

“I kanë marrë dhëmbët e arit!” bërtiti burri. “Po. Po.” u dëgjua nga burrat e djemtë pas tij. “Le t’i kontrollojmë!” se kush tha.

Tre shokët iu kontrolluan të parët. Sapo i gjenin dhëmbin në xhep, i shpërthenin trutë me plumb. Për të shpëtuar, kur po bërtiste se ai s’kishte asnjë, i futi dhëmbët në grusht, përplasi grushtin me gojën dhe i kaloi në bark. Ata e kontrolluan e s’i gjeten gjë.

I tronditur arriti në shtëpi. U shtri të flinte pa folur me njeri. Në mëngjes, kur shkoi të rruhej, vuri re se në pasqyrë nuk ishte ai. Një grua e moshuar, fytyrë e njohur, me në gojë gjashtë dhëmbë që i mungonin, bënte çdo gjë njëlloj me të. Po, ajo ishte. Ajo që kishin varrosur dje.

U zgjua i tmerruar! Asnjë ditë të vetme nuk kishte punuar në varreza. Madje, gjatë gjithë jetës i ishte shmangur varrimeve, pikërisht për shkak të një pështjellimi të çuditshëm që mendonte se i shkaktonte të vdekurit. Me bindje mund të thoshte, madje edhe të betohej, se kurrë, as edhe një herë, nuk kishte parë një kufomë.

Pse? Pse pikërisht atë ëndërr? Çfarë e kishte shkaktuar? Nga kishte ardhur? Çfarë donte të thoshte? Po pse, a duan të thonë diçka ëndrrat? A flasin ato? Nëse flasin njerëzit,



patjetër edhe ëndrrat thonë diçka. Sepse komunikimi nuk është vetëm pasojë e së folurës, apo jo?

Frikësohej të shkonte në tualet apo diku ku do të përballej me një pasqyrë. U kthye përmbys, me kokën e ngulur në nënkresë e sytë e hapur në një përqendrim të jashtëzakonshëm, thua se aty do të gjente shpjegimet e kërkuara.

Tash disa net, ndër mend i vinte e njëjta gjë. Nuk e kishte dëgjuar askund krejt ashtu sikurse e mendonte, por copëza prej asaj çka i vërdallosej në kokë ishin mbledhur nga të katër anët gjeografike dhe kronologjike.

Vjen një moment gjatë jetës në çift, kryesisht disa muaj pas fillimit të marrëdhënies, kur njeh te tjetri aspektet njerëzore. Kështu, nga retë ku jeni, bie dhe kupton se jeta duhet jetuar në tokë. Entuziazmi i parë shuhet, pendët shumëngjyrëshe bien. Mbetet veç diçka në të cilën janë të gjitha ngjyrat, por që nuk shihen asnjëherë së bashku, vetëm duke lëvizur nga njëra pikë në tjetrën. Ajo është dashuria.

Të dashurosh në muajin e parë është shumë e thjeshtë. Edhe në të dytin e në të tretin. Me fat janë ata që me kaq thjeshtësi vijojnë dhe në të katërtin. Por mandej, kur bëhet zgjedhja a duam t'i qasemi me seriozitet dashurisë apo jo, po u vendos e para, rrethi brenda të cilit ajo jetohet nis të ngushtohet, aq sa thuajse shndërrohet në pikë. Po ia dole të krijosh vend mjaftueshëm për veten dhe tjetrin brenda asaj pike, dashuria triumfon e pas saj, gjithçkaja juaj ndihet sikur merr tatëpjetën dhe mund t'ia gjesh zgjidhjen veç duke i

dhënë kohë. Pasi ke filluar t'i njohësh të metat, frikërat, dyshimet, mërzitë, traumat, i gjendur me të brenda asaj pike kupton se çdo gjë që as nuk e imagjinoje para se ta puthje, po nëpërmjet të njëjtave buzë po kalon brenda teje, po bëhet pjesë e jotja. Me të mbërritur këtu, të qartësohet se dashuria jo vetëm ka triumfuar, por ia ka dalë të kthehet në diçka solide, tejet të fortë.

Pikërisht në këtë çast, kur e kishte sistemuar dashurinë si kategori që shkon përtej njohjes, qe ndier bosh. Dhe tanimë, kjo për kurrfarë arsyeje nuk po i shqitej nga koka.

Sa herë e flisnin njohjen e tyre, me njëri-tjetrin, me veten apo me këdo, fillonin po njëlloj: Ishte e martë, një ditë ashtu sikurse për këdo, edhe për ne plot me ters, kur dolëm në takimin tonë të parë.

Njiheshin qysh më përpara, si dy shokë që flisnin gjithçka bashkë, qanin çdo hall e përplasnin çdo problem te tjetri, sa herë puna u jepte pak hapësirë. Aq të afërt ishin, saqë mund të thuhet se dinin edhe historitë romantike të sho-shoqit. Ndoshta e teproj pak me fjalën romantike, por të paktën ata me të cilat mbysnin epshet, i rrëfenin si fjalë të ndenjura në avujt e verës. Secili e kishte bindur veten se mes tyre kishte vetëm shoqëri të qashtë dhe aq, pa lënë ndonjëherë as shkakun më të vogël nga ku të mbinte ndonjë keqkuptim.

Atë të martë, pas një të hëne dërrmuese, e ndanë mendjen: Duhet të pinin, ta tepronin e kështu, të harronin. Pinin shpesh, kryesisht nën shoqërinë e të tjerëve, por së bashku, vetëm ata të dy, ishte hera e parë.

Pinë dhe folën, jashtë natyrës së tyre, pa pushim. Thanë brenda pak orëve shumë më shumë nga sa patën thënë qysh kur ishin njohur. Pastaj, kur rrezet e agimit u shtriquën nën zhurmën e fortë të një bubullime të papritur, kuptuan se duhet të iknin. Ai e përcolli deri në shtëpi, e përqafoi, e puthi në faqe dhe iku, ngadalë, me kokën lart e sytë në qiell, drejt e në shtratin e tij.

Gjatë gjithë javës e mendoj, rimendoj, shikoj e rishikoj porsì vegim atë natë, plot shpresë se sërish, në të ardhmen që ëndërronte të mos ishte e largët, do të përsëritej. Pas shtatë ditëve të kaluara si përjetime të thata e të zbrazëta, erdhi një e martë tjetër, jo si ajo e ëndërruara prej tij. Po, pjesa e parë ashtu shkoi: pinë dhe folën, pastaj u nis ta përcillte e para shtëpisë së saj, ta përqafonte. Nuk imagjinonte dot më shumë. Asnjë pikëz loti e rënë nga mendja e tij nuk e mbyllte brenda vetes atë çfarë ndodhi. Ajo, pas hezitimeve e mëdyshjeve të pafundme, iu afrua dhe e puthi. Po, në buzë. I tromaksur, i frikësuar, dyshues, ai u zbraps, një hap, për t' u afruar dy të tjerë drejt saj, që ta puthte, fort, pa pushim. Dhjetëra herë, deri në shtëpi. Në çdo rrugicë. Nën çdo ballkon. Pranë çdo peme. Mbi çdo gjethe. Aq i dehur sa ishte, pa një qiell të mbyllur brenda syrit të saj, qiell më i madh, më i gjerë, me më shumë yje se ai që po u rrinte mbi kokë, qiell që i tregonte se aty mund të fluturonte dhe të eksploronte vende të tjera, të panjohura, krejt i zhveshur nga gjithçka përbënte realitetin e atij çasti apo çdo çasti tjetër të kaluar deri atëherë prej tij.

Me buzët e bashkuara në puthje, u ndanë. Ai vodhi një

biçikletë dhe iku, duke e kthyer kokën e zgjatur qafën për ta parë atë që nuk po ikte, por rrinte dhe e shihte, deri kur boritë e makinave nga pas, pavarësisht këmbënguljes së tij prej të dehuri për të mos lëvizur, pushuan dhe u nisën për ta përplasur, por ai e kapi dhe u fut mes një rrjeti rrugësh që përbënte pezhishkën e qytetit.

U takuan sërish pas dy ditësh, në një të enjte të bymuar si pikë vese në skajin më të lartë të fijos së barit. Nuk u puthën. Shkuan më tej në këndin përballë atij ku kishin qenë të martën: as duart s'i shtrënguan. Për të ishte e vështirë ta braktiste atë qiell të ri, të sapozbuluar nën ballin e saj, por nuk kishte tjetër zgjidhje përveçse të pranonte zgjedhjen e dhënë nga ajo. Sensi i tepruar i lirisë është tipari që qysh atëherë e ka karakterizuar.

Fjeti si qengj. I tha vetes se ai në sytë e saj s'ishte qiell, por veç një shkreptimë, ndezje-fikje e dritës gjatë një kapitjeje të syve. Prandaj ishte krejt i qetë të premtën kur u panë, sikur ato dhjetë ditë të mos i kishte jetuar dhe ajo e premtë të ishte dita e parë pas së hënës dërrmuese. Por jo, s'qe kështu.

Gjurmët e gishtave të saj, gjatë gjithë mbrëmjes së asaj dite, ia përshkuan trupin nga koka te këmbët. Sa herë i kalonte pranë, e prekte, lehtë e pa mendje, dhe pikla të ftohta avulli i rrëshqisnin nga balli, shpatullat, gjunjët, ia mbushnin lëkurën. Frika mos kishte të bënte vërtetë me veprime rastësore të keqkuptuara prej tij po e digjte, por përvëlmin ia jepte dëshira për të mos qenë ashtu. Dhe kishte të drejtë: Ajo e pëlqente, shumë! Ndërsa për të ishte

diçka tjetër. Sa herë ndiente se mespërmes ajrit që i ndante kalonin flutura prej fjalëve të saj, pinte me gota të mbushura grykazi, pa e ditur a po i vriste apo po ua thjeshtonte rrugën drejt stomakut të tij. E donte!

Ia tha këtë një natë, jo shumë pas asaj të premtjeje, kur gjendej përballë atij qielli që doli të mos kishte qenë veç një feksje e çastit. Sa e dëgjoi, ajo qeshi, ashtu sikurse vetëm ajo mund të qeshë, lehtë, me cipat e buzëve që ngrihen si krahë të gatshëm për një përqaftim. E puthi, me dhëmbët e vegjël, shumë të vegjël e mandej i kafshoi lehtë po me to buzën e poshtme.

“Të frikëson kjo?” e pyeti ai, i kapërthyer me trupin e saj në përqaftim.

“Jo!” i tha ajo. Edhe cipat e syve, njëlloj si të buzëve, ishin ngritur lart: i qeshte çdo muskul i fytyrës. Një javë më vonë, edhe ajo ia tha: ndihej njëlloj, madje qysh para se ai t’ia kishte rrëfyer.

Tani kishte frikë. Prej kohësh nuk donte njeri dhe prej më shumë kohësh, nuk duhej prej njeriu. Si mund të zinte vend në një realitet të atillë?

Prit, një shkëputje e vogël:

Ai është më i gjatë se ajo. Qysh kur u puthën për herë të dytë, ai e përcjell natëpërnatë në shtëpi. Para se ta lërë te rrugica në fund të së cilës ka pallatin, e puth në buzë, por që të sajat të jenë në të njëjtin nivel me të tijat, ajo hipën në një këmbë shkalle para një kinkalerie.

Një natë, tani vonë, i mbytur në pellgun e mallit për të, i

hipi biçikletës, shkoi aty, u ul në gjunjë para derës së xhamtë të asaj godine, sikur të gjendej para ndonjë tempulli, dhe me forcë, ndihmuar nga një pllakë trotuari që e hoqi shumë më lehtë nga sa pandehu, shkuli pllakën e mermertë të shkallës. E vendosi pas në biçikletë, mori për në shtëpi, rrugës u ndal të blinte çimento dhe me të arritur, e ngjiti në parmakun e derës së dhomës së tij. Tani, sa herë hyn apo del, për të fjetur, punuar apo qëndruar, shkel mbi të e i bëhet se buzët e saj i ka përballë, gati për t'u puthur.

Kthehemi, po ku të shkojmë?

Ai vijon të jetë përmbys, me kokën e futur thellë brenda nënkresës.